

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

11.06.2024

Ora, 11:00

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin e:

Kërkesës ankimore nr. 05, datë 8.05.2024 të depozituar nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”;

kërkesës ankimore nr. 6, datë 22.5.2024, të depozituar nga subjekti “Partia Ardhmëria Shqiptare”;

kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.5.2024 të depozituar nga subjekti “Bindja Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali, z. Koli Bele.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** BD (z. F. Topollari), PASH (z. E. Subashi)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 5 të cilës i është bashkuar edhe kërkesa ankimore me nr. 6 dhe 7. Do të rifillojmë këtë seancë, aty ku e kemi lënë herën tjetër. Arsyeja e ndërprerjes së seancës ishte, sepse përfaqësuesit e Partisë Ardhmëria Shqiptare, të cilët kanë depozituar kërkesën ankimore me nr. 6, nuk kishin mundësi objektive të ishin prezent në seancë. Për këtë arsye KAS e ndërpreu seancën për t’i dhënë mundësi palës ankimuese për të dhënë shpjegimet e saj dhe për t’u dëgjuar përpara

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

këtij komisioni. Ndërkohë që për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë dhe subjektin tjetër Bindja Demokratike, KAS e ka zhvilluar procedurën e dëgjimit. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që në qoftë se do të keni diçka të re sot, të keni mundësinë të jepni përsëri shpjegime. Verifikojmë prezencën! Është prezent trupa e KAS, në përbërje të tij janë katër anëtarë, për shkak se kolegu Braho mungon sot për shkaqe të arësyeshme. Kjo nuk e pengon komisionin të vijojë normalisht me shqyrtimin e kërkesës, për shkak se dhe numri i nevojshëm i anëtarëve për vendimmarrje është prezent. Është prezent administrata e KQZ-së që do të përfaqësojë Komisionerin në këtë procedim administrativ dhe që drejtohet nga drejtoresha juridike e institucionit, zonja Koja. Është prezent përfaqësuesi i partisë politike Ardhmëria Shiptare, ju lutem prezantohuni!

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Kryetari i partisë Emin Subashi!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Është prezent dhe përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike. Nuk janë prezent në sallë, përfaqësuesit e Partisë Socialiste, të cilët mesa duket e kanë konsideruar të ezauruar shpjegimet e tyre në seancën e kaluar. Fillojmë pa humbur kohë, do t'i jap fjalën shkurtimisht, përfaqësuesit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të na argumentuar sanksionin dhe arsyen, pse Komisioneri ka vendosur sanksionin ndaj jush. Më pas do ta keni ju fjalën për të dhënë shpjegimet e nevojshme për KAS-in, faleminderit! Zonja Koja, fjala për ju!

Znj. M. Koja: Në vijim të shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 6, të depozituar nga partia politike Ardhmëria Shqiptare, pasi me vendimin e KSHZ në auditimin e raportit financiar për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022, është konstatuar nga audituesi se, për Partinë Ardhmëria Shqiptare nuk është kryer

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

auditimi, pasi partia rezulton në listën e subjekteve me status pasiv. Në këto kushte është propozuar., vendosur gjoha gjashtëdhjetë mijë lekë në zbatim të nenit 23/4, pika 1, të ligjit “Për Partitë Politike”. Faleminderit!


Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë, zoti kryetar i partisë, do të flisni vetë, apo keni përfaqësues?

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Jo, jo do flas unë!

Z. E. Çefa: Dakord!

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Përshëndetje! Partia Ardhmëria Shqiptare, në këtë gjykim administrativ në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, kundër vendimit nr. 38, datë 9.04.2024 të KSHZ, përfaqësohet kryesisht nga kryetari aktual Emin Subashi. I qëndrojmë ankimit që i jemi drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve me nr. prot 1325, datë 25.05.2024 që kemi dorëzuar ankimin. Për sa i përket datës që ishte caktuar, ne nuk kemi marrë njoftim dhe një nga shkaqet që është shtyrë kjo seancë ishte, sepse ne nuk kishim marrë njoftim. Ne themi dhe në materialin ankimes që kemi dorëzuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përdor dy standarte, gjë që në gjykimin tonë është i paligjshëm. Njoftimi duhet të bëhet në rrugë postare siç e ka ligji, ose në rrugë elektronike, por duhet të ndiqet procedura siç e ka ligji. Pra, duhet mbajtur shënim, data, ora, kush e mori njoftimin nëpërmjet kujt. Më erdhi në WhatsApp, më erdhi shumë në rregull, e mora dhe i dhashë dhe konfirmimin menjëherë personit të Komisionit Qendror që më bëri njoftimin. Pra, këtu kemi vërejtje, themi të korigjohet se është në interes të të dy palëve. Janë procedura që ligji i kërkon dhe duhen zbatuar. Nga ana jonë si subjekt politik, që


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

jemi ndëshkuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në masën gjashtëdhjetë mijë lekë të reja, e kundërshtojmë për faktin sepse ne nuk jemi para kushteve të nenit 23/4, pika 1. Ligji “Për Partitë Politike”, thotë shprehimisht “Kur partitë politike nuk paraqesin raportin financiar brenda datës 31 marsit të çdo viti të përvitshëm, përbën shkak të trajtohen me këtë nen për shkeljet”. Partia Ardhmëria Shqiptare, këtë material, flas për vitin 2022, e ka dërguar pesë ditë para afatit të skadimit. Ekziston dhe është me numër protokollit që e keni dhe ju të shkruar në ankim. Pra, është numri i protokollit 1973, të datës 27.03.2023. Po të bësh llogaritjet aritmetike del pesë ditë para afatit. Ne jemi ndëshkuar padrejtësisht me këtë. Unë e kam këtu praktikën që ua kemi dërguar me vulë, me firmë, me protokoll, me të gjitha i kemi këtu. Janë të gjitha, edhe faturat financiare origjinale, siç jua kemi dërguar dhe ju KQZ-së, që partia në këtë vit që ka raportuar për financimet është me borxhe. Sigurisht me borxhe janë partitë e vogla se nuk diskutohet se ne nuk kemi marrë asnjë lloj fondi. Megjithatë ne i raportojmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve siç e ka ligji. Kemi bërë dhe një vërejtje aty, mbase do të jetë e arsyeshme. Mundet, se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit që të nxjerrë akte normative nëpërmjet Komisionit Rregullator, sepse është rregulluar edhe Kodi Zgjedhor, edhe ligji “Për Partitë Politike”, që të mund t’i thjeshtojë disa gjëra. Kur një parti politike nuk merr asnjë lloj fondi çfarë kërkon? Në qoftë se ka nevojë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që ne t’i dërgojmë vetëm letra, është anë tjetër. Në qoftë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon që ne t’i japim informacion të saktë dhe të jemi realë dhe të mos i qëndrojmë informimit införmal, por t’i japim atë që duhet. Megjithatë kjo është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sepse ligji ia ka deleguar atij të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka ndaj partive politike. Kam dhe një vërejtje për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kryesisht për Komisionerin, i cili me partitë politike duhet të mbajë lidhje, sepse edhe ligji në këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

prizëm e trajton. Pra, duhet të ofrojë bashkëpunim, jo vetëm ndëshkime. Ndëshkimet ekzistojnë nuk e diskutojmë se e ka ligji, por nëse neni 23 e parashikon dënimin maksimal një milion lekë, ti jep maksimalin, por ekziston dhe minimali. Edhe gjykatat kur japin vendime mbi këtë prizëm gjykojnë, sepse ligji është favorizues. Tjetër, për sa i përket, se ato fletët, mbase e kam dhe unë gabim që se kam lexuar mirë, por për sa i përket formularit.. ne kemi pas një formular tip, shtojca 1 që është prodhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve para Komisionit Rregullator, ai ka qenë tip. Është përdorur nga 2020 deri në 2022. Në vitin 2023 ka dalë vendimi nr. 15, i cili është përdorur ai formular për vitin 2023, që është dhënë për vitin 2024, me atë kemi raportuar, me atë i kemi dhënë, ndërsa të gjitha të dhënate tjera i kemi bërë në bazë të shtojcës që na është dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjithsesi, ne në ankim shtrojmë dhe një problem tjetër që ka të bëjë dhe me bashkëpunimin e KQZ-së me partitë politike. Lidhur me dërgimin e formularëve, në rast se kërkohet formular tip që ne të sjellim në KQZ, siç na u dërgua në vitin 2023, ka pasur parregullsi në këtë gjë, duhet të na dërgohet me postë. Ne na thuhet “merreni në faqen zyrtare”. Në faqen zyrtare ka ngarkesë dhe shpesh herë nuk shkarkon asnjë lloj materiali. Ne e kemi pasur shumë të vështirë për vitin 2023 për të shkarkuar materiale në atë faqe. Pra, të na dërgohet dhe në mënyrë manuale, njëkohësisht ta marrim dhe në internet. Partitë e vogla nuk i kanë të gjitha akseset siç i kanë partitë e mëdha politike. Ne mendojmë, se nuk duhet të jetë njësoj formulari, kështu mendojmë ne, por këtë duhet ta shohë dhe komisioni. Formulari nuk mund të jetë njësoj me Partinë Socialiste dhe Partinë Demokratike, apo me partitë e tjera parlamentare që kanë fonde. Partitë e vogla janë me “0” fonde. Ne shkruajmë vetëm “0”. Përfundimisht ne kërkojmë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, që vendimi nr. 38, dt. 9.04.2024, në gjykimin tonë është i paligjshëm, është i parregullt, sepse nuk përmbush ato detyrime dhe nuk mbështetet në nenin 23/4, pika 1. Ne e

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

kemi dorëzuar materialin në kohë dhe kemi të gjithë praktikën që mund t'jua vemë në dispozicion që ta shihni. Ju faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Pyetje nga kolegët?

Z. K. Bele: Zoti Subashi, dëgjoj këtë konceptin se në fakt kam dashur të pyes dhe më parë, të pezullimit të subjektit. Ju keni dorëzuar njoftim në tatime apo diku tjetër, kur thoni që jemi të pezulluar? Çfarë pezullimi?

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Statusi i Partisë Ardhmëria Shqiptare është “pasiv”.

Z. K. Bele: Çdo të thotë kjo?


Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Është në statusin pasiv, sepse Partia Ardhmëria Shqiptare, duke mos pasur të ardhura për të paguar detyrimet, se më parë kemi paguar detyrime dhe i kemi këtu, i kam paguar unë nga xhepi këto. Ne në bashkëpunim me tatimet e kemi kaluar Partinë Ardhmëria Shqiptare në statusin pasiv.

Z. K. Bele: E kuptova, nga pikëpamja financiare, statusi pasiv. Kam një pyetje tjetër? Kur keni marrë pjesë për herë të fundit në zgjedhje?

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Në vitin 2023!

Z. K. Bele: Keni qenë pjesë e zgjedhjeve të vitit 2023.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Po!

Z. K. Bele: Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Pyetje të tjera? Kam unë një pyetje për administratën. Konkluzioni i ekspertit është i thjeshtë, thotë "Audituesi nuk e ka kryer auditimin, pasi partia rezulton në listën e subjekteve me status pasiv". Kjo do të thotë, në qoftë se mundeni administrata e KQZ-së me na sqaruar pak, kaq është veprimi i audituesit, thjesht.. nuk e ka filluar aspak auditimin. Thjesht ka marrë informacionin që subjekti ka statusin "pasiv" dhe nuk i ka hyrë fare gjësë.

Znj. J. Josifi: Në raportin përmbledhës audituesja ka pasur për të audituar disa parti politike për vitin 2022, shprehet se janë konstatuar dy parti si subjekte pasive, njëra nga të cilat është ankuesi. Ajo sqaron se këto subjekte kanë dorëzuar pasqyra financiare për vitin 2022. Pra, e kanë përmbushur detyrimin ligjor për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por në sistemin tatimor janë me status pasiv dhe audituesja jep bazën ligjore që është ligji 9920 i vitit 2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 44/7, ku thekson se "Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, .." siç ishte ky rast në atë moment, në kohë, ".. konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj". Fakti që partia politike ka kaluar në regjistrin pasiv, nuk do të duhet të kishte kryer as edhe një transaksion. Në raportin financiar të dorëzuar nga partia, rezultojnë të ardhura dhe shpenzime, pra rezultojnë transaksione...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Z. E. Çefa: Qartë, qartë, që ta bëjmë më mirë pyetje-përgjigje. Tani, ekspertia thotë “Ky ka shkel ligjin “Për Partitë Politike”, apo ka shkel ligjin 9920, për të cilin duhej të gjobitej pse ka kryer deklarime dhe veprime megjithëse kishte statusin pasiv”?

Znj. J. Josifi: Të dy ligjet, sepse ligji 8580 i vitit 2000 “Për Partitë Politike”, neni 23/1, pika 4 thotë: “Çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi”. Çdo shpenzim duhet të respektojë legjislacionin tatimor. Legjislacioni tatimor është ai që citon audituesja. Ligji 9920 “Për procedurat tatimore”, neni 44/7, ku thekson se "Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj". Në raportin financiar, në faqen 2 dhe 3 të partisë, kjo parti ka deklaruar të ardhura dhe shpenzime për vitin 2022 pra, ka kryer transaksione.

Z. E. Çefa: Qartë, jam krejt i qartë. Pyetja ime ishte kjo, në qoftë se po prezumojmë faktin që tatimet i bëjnë kontroll subjektit dhe e gjobisin për të njejtën gjë por me bazë ligjore, ligjin 9920, edhe ne e gjobisim për të njejtën gjë por me bazë ligjore ligjin “Për Partitë Politike”, duket pak sikur po ndëshkohet dy herë për të njejtën shkelje subjekti, apo jo? Pra, në opinionin tuaj, a ka përplasje të këtyre dispozitave a ka mbivendosje? A mos vallë duhet të argumentohet, po themi, në rastin konkret se si nëpërmjet këtyre veprimeve, subjekti ka shkel pikën 1, të nenit 24, të ligjit “Për Partitë Politike”, që flet qartësisht për dispozitat për financimin e partive. Ne nëse do ta gjobisim, e bëjmë këtë se ka shkelur dispozitat për financimin e partive politike ne nuk na intereson, nuk është lëndë e jona, a e respektojnë ligjin tatimor partitë, apo jo? Këtë e kontrollojnë tatimet dhe e gjobisin apo jo e dijnë ata. Ne kontrollojmë vetëm shkeljen e dispozitave për financimin e partive.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

Znj. J. Josifi: Shkelje e dispozitave për financimin e partive është neni 23/1, pika 4 që ju citova. Pra, nuk mjafton të kryesh shpenzime dhe të ardhura, por duhet edhe t'i dokumentosh ato, sipas legjislacionit specifik në fuqi, i cili është legjislacioni tatimor. Megjithatë duke qenë "*post factum*", se ne po flasim për raportin financiar të vitit 2022, partia e di nëse është kontrolluar nga organet tatimore dhe është gjobitur apo jo për të njëjtën shkelje dhe në ç' masë. Thjesht për të verifikuar a ka dublikim, por besoj se nuk është ky rasti.

Z. E. Çefa: Zoti Subashi, a mund t'ju bëj një pyetje, ju lutem? Ju keni deklaruar aktivitet financiar, megjithëse ishit me status të pezulluar dhe ligjërisht nuk mund të kryenit asnjë transaksion financiar. Përse e keni bërë këtë?

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Unë deri më sot, këtë ma ka thënë dhe një ekspert, se këta gjykojnë nga mendimi i një eksperti. Unë e kam shkruar aty, Fatmira Kastrati. Ajo duhet të bëjë detyrën e ekspertit me saktësi.

Znj. J. Josifi: Ju lutem, vetëm për saktësi, është audituese tjetër.

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Nuk kam asgjë me ekspertin unë, e kam me ju si Komision Qendror i Zgjedhjeve, me cilësinë që duhet të përzgjidhni ekspertin. Ekspertia duhet të flasë si eksperte. Ka një dispozitë procedura civile, që eksperti duhet t'i nënshtrohet çdo lloj ekspertize. E kam thënë dhe në ankim, që edhe në vitin 2021 që ka ekspertuar Partinë Ardhmëria Shqiptare, edhe në vitin 2023 po me të njëjtën gjuhë flet, që partia është në statusin ... Cili ligj., Kodi Zgjedhor që është ligji bazë për partitë politike për sa i përket procedurës në zgjedhje që të marrë pjesë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

e pengon? Cili ligj? Cili nen nga partitë politike e pengon një parti politike që qenka në statusin ... kjo ka lidhje me tatimet. Ne nuk bëjmë transaksione. Partitë e vogla nuk bëjnë transaksione me tatimet. Çfarë e lidh një parti politike që nuk ka asnjë qindarkë të ardhura nga buxheti i shtetit të lidhet me tatimet. Nuk është subjekt i organeve tatimore në bazë të nenit 6, të ligjit mbi tatimet. Duhet lexuar mirë ligji, jo kështu!

Z. E. Çefa: Administrata, do të na i vini pak në dispozicion këtë raportin financiar që ta administrojmë si provë.

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Ne kemi bërë raport financiar, sepse na e kërkon ligji.

Z. E. Çefa: Qartësisht dakord, ju faleminderit! Atëherë, pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka! Në këtë fazë, unë mendoj se u ezaurua debati, kështu që për të tre subjektet ankimuese, ne do të kalojmë në fazën e konkluzioneve përfundimtare. Meqenëse Partinë Socialiste nuk e kemi, do të fillojmë me ju që jeni... përfundimisht, zoti Subashi, çfarë kërkonte nga KAS?

Z. E. Subashi, kryetar i PASH: Ne kërkojmë rrëzimin e vendimit nr. 38, datë 9.04.2024 të KSHZ për pjesën ku ne jemi ndëshkuar, për pjesën tjetër i takon atij të veprorë sipas ligjit. Jemi ndëshkuar padrejtësisht. Po t'i referohemi nenit 23/4, pika 1, ajo flet për raportimin financiar, të cilin ne e kemi dorëzuar në bazë të ligjit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në kohë dhe në bazë të rregullave. Për sa i përket atyre çfarë lidhen me tatimet, mendoj se ajo nuk është pjesë e këtij gjykimi, nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

është objekt i këtij gjykimi, është problem tjetër. Atëherë të shtohet në ligj, a të thuhet se pengohet kjo parti politike, që kur të marrim pjesë herë tjetër në zgjedhje, në se jemi me statusin pasiv... se ajo është diçka, nuk ka nevojë për vendime, është në kompetenën e drejtuesit që ta bëjë nga pasiv në aktiv. Nuk ka të bëjë me pjesën e vendimmarrjes.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Për Partinë Bindja Demokratike, përfundimisht ju lutem?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Përfundimisht, ne kërkojmë që të rrëzohet ky vendim, për shkak se në gjykimin tonë nuk është i bazuar edhe në fakt. Herën e kaluar, duke qenë se në atë seancë, unë u njoha me provat që kishte audituesi, desha vetëm një shtesë të vogël të bëj. Jam lidhur me financierin e partisë, më ka sqaruar aq sa ka mundur të më sqarojë se nuk ndodhej brenda vendit. Ai mbante mend që në periudhën që janë dërguar këto emaile, është e vërtetë që janë dërguar dhe ka qenë emaili im dhe ka qenë ai që është lidhur më pas dhe ka vazhduar procedurën me audituesin për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm. Është lidhur në formë telefonike, më ka njoftuar dhe mua në atë kohë, që është lidhur në atë formë dhe nga ajo që më deklaroi është takuar me audituesin dhe madja i ka dorëzuar një raport bankar të lëvizjeve vetëm të bankës. Kjo është sa i përket aspektit të faktit. Për sa i përket aspektit të ligjit, meqenëse u bë një debat për çështjen e statusit pasiv, nga kontrolli financiar i Bindjes Demokratike për fushatën e vitit 2023, në bazë të atij raporti edhe Partia Bindja Demokratike ka qenë në të njëjtin status që në vitin 2020 që evidenton ky raport. Desha t'jua bëj të ditur edhe këtë fakt. Për gjykimin tonë nuk... ne duhet të dënohemi në rastin se kemi refuzuar të bashkëpunojmë me audituesin? Në gjykimin tonë nuk është ky rasti. Ne i kemi kthyer përgjigje

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

audituesit. Financieri ynë është takuar me të, ka realizuar takim me të dhe ne pretendojmë që kemi dorëzuar dokumentat që na janë kërkuar. Për këtë arsye, në gjykimin tonë, nuk mbështetet as në fakt, as në ligj ky dënim, ndaj kërkojmë rrëzimin e tij.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! KQZ-ja, shkurtimisht për të tre kërkesat ankimore, qëndrimin final!

Znj. M. Koja: Ne kërkojmë që KAS të vendosë për lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit për sanksionimin e partive politike, faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim, pas 30 minutave do të rimblidhemi këtu, për të shpallur vendimin, ju faleminderit!

Rifillon seanca

Ora, 11:58

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit. KAS pasi diskutoi çështjen në tërësi vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 5, dt.8.05.2024 të Partisë Socialiste të Shqipërisë, por lënien në fuqi të sanksionit, të vendosur me vendimin nr. 38 të vitit 2024 të KSHZ për këtë subjekt.

- Rrëzimin e kërkesës ankimore me nr. 6, dt. 22.05.2024 të Partisë Ardhmëria Shqiptare dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 38 të vitit 2024 të KSHZ për këtë subjekt.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.06.2024*

- Rrëzimin e kërkesës ankimore me nr. 7, dt. 29.05.2024 të Partisë Bindja Demokratike dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 38 të vitit 2024 të KSHZ për këtë subjekt.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të KQZ-së.
 - Ndaj këtij vendimi lejohet ankim nga subjektet përkatëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit ligjor dyzet e pesë ditë nga njoftimi i tij.
- Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur, ju faleminderit për pjesëmarrjen.

Vendimi nr. 12

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*